



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 10-320/01-0014724/26
No. 24 04 2026
Data 24 04 2026
Data



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Direkcia za Poljoprivredu Sumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture Forestry and Rural Development

DATËA:	24.04.2026
PËR/ZA/TO:	Fermerët e komunës se Skenderajt
PËRMES:	z.Sami Lushtaku - Kryetarin e Komunës,
NGA/OD/FROM:	Sabit Ferizi, Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
TEMA:	Thirrje publike për fermerët për aplikim për përfitim me mekanizëm bujqësor, serra dhe pajisje për sektorin e bletarisë dhe blegtorisë

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural njofton të gjithë fermerët e Komunës së Skenderajt se është hapur thirrja për aplikim për përfitim nga grantet, të cilat përfshijnë mekanizëm bujqësor, sera, si dhe pajisje për sektorin e bletarisë dhe blegtorisë.

Në këtë thirrje do të shpërndahen:

- Motokultivatorë me freza;
- Serra 50 m² dhe 100 m²
- Duplikatorë për bletari;
- Makinë mjelëse për lopë qumështore

Kushtet për aplikim

- Të jetë banor i Komunës së Skenderajt (kopje e letërnjoftimit);
- Të jetë i regjistruar si fermer para datës së publikimit të thirrjes për aplikim;

Kriteret e përgjithshme

1. Aplikuesit për motokultivator me frezë duhet të jenë kultivues të perimeve;
2. Aplikuesit për serra duhet ti ketë se paku 0.05 ha toke të punuar
3. Aplikuesit për makinë mjelëse duhet të kenë së paku 5 krerë lopë.
4. Aplikuesi për Duplikator duhet ti ketë se paku 20 koshere me bletë
5. Aplikuesit (fermerët) të cilët nuk kanë përfutuar ndonjë projekt gjatë tri (3) viteve të fundit nga komuna dhe donatorët e tjerë kanë përparësi.

Dokumentacioni i nevojshëm

- Formulari i aplikimit (merret në komunë);
- Kopje e letërnjoftimit;
- Certifikatë e regjistrimit të fermerit(NIF)
- Certifikatë mbi pronësinë e tokës (për aplikuesit për serra)
- Dëshmi për numrin e bletëve/kafshëve (aplikuesit për duplikator dhe makinë mjelëse)
- Dëshmi e bashkësisë familjare

Bashkëfinancimi

- Fermerët përfutues do të marrin pjesë me **30%** të vlerës së projektit
- Komuna, do të marrë pjesë me **70%** të vlerës së projektit

Vërejtje

- Fermerët kanë të drejtë aplikimi vetëm për **njërën** nga pajisjet e lartcekura.

Dorëzimi i aplikacioneve

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Komunës së Skenderajt.

Afati për aplikim

- Afati për aplikim është prej datës **24.04.2026** deri më **15.05.2026**, ora **16:00**.